

Trajnimi ,zhvillimi profesional dhe Licencimi i Mësimdhënësve

Progresi dhe gjendja aktuale –


Sektori i Trajnimeve, MASHT



Zhvillimi Profesional i Mësimdhënësve


Hyrje

- Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Republikën e Kosovës ka kaluar nëpër një dekadë të ristrukturimit intensiv që ka synuar avancimin e cilësisë së mësimdhënies e të nxëniet në shkolla dhe kompensimin e humbjeve në rrethana jashtëzakonisht të rënda gjatë viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar.

- 
- Qasja në planin afatgjatë është që të standardizohen si përgatitja para shërbimit ashtu edhe aftësimi pa shkëputje nga puna me qëllim që të përmirësohet mësimdhënia dhe të nxënit në shkollat e Kosovës, në mënyrë që zhvillimi profesional i mësimdhënësve të organizohet si arsimim fillestar (para shërbimit) i mësimdhënësve, dhe zhvillim i vazhdueshëm profesional (aftësimi i mësimdhënësve pa shkëputje nga puna). MASHT do të vazhdojë të marrë parasysh këtë zhvillim si fazë kyçe në procesin e Licencimit e mësimdhënësve.

Trendët kryesore

- *Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT) tani ka radhitur zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe të administratorëve të arsimit në mesin e prioriteteve të veta më madhore. Duke u bazuar në praktikat e mira dhe standardet e BE-së për mësimdhënës*
- Pjesë e reformimit të sistemit arsimor në përputhje me zhvillimet evropiane të arsimit është edhe procesi i aprovimit të dokumentit të KKK.

- 
- Komponenta e Zhvillimit Profesional të mësimdhënësve nuk është proces i izoluar, por duhet të ndërlidhet me aspektet tjera të avancuara të sistemit të licencimit, veçanërisht standardet e mësimdhënies, vlerësimin të performancës, monitorimin e procesit, akreditimin e programeve dhe ofrueseve të trajnimeve, si dhe trendët tjera në sistemin e arsimit.

Specifikat

- MASHT e ka vënë si prioritet zhvillimin profesional të mësimitdhënësve për tri arsye:
- për t'u siguruar që metodologjitë e reja të mësimitdhënies në shkollat e Kosovës janë të vazhdueshme dhe cilësore,
- për të përkrahur mësimitdhënësit në zbatimin e Kornizës së Re të Kurikulës së Kosovës, , si dhe
- në ndërtimi i një sistemi të licencimit të qëndrueshëm të mësimitdhënësve si metoda më e mirë për të realizuar këto proceset ,(zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe vlerësimin e performancës së mësimitdhënësve).

Intervenimet kryesore

- *Për rritje të cilësisë në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve të përcaktuara sipas objektivave në PSAK dhe në dokumente tjera janë bërë intervenime në disa drejtime, sipas prioriteteve dhe mundësive buxhetore.*
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (në vjetët e fundit, MASHT-i e ka financuar programin për shkathtësitë në kompjuterë – Licenca Evropiane e Përdorimit të Kompjuterit (ECDL) – për 12.743 mësimitdhënësit);
- OJQ dhe OQ-të, partnerët zhvillimorë (CIDA, GiZ, USAID, Swiss Contact, etj.) janë përfshi në trajnime 643 drejtor dhe afër 10.000 mësimitdhënës të shkollave. Nga këto të dhëna janë pasqyruar numri I pjesëmarrësve disa here në trajnimet e ndryshme.
- Universitetet I prishtinës në bashkëpunim me MASHT-in,ka organizuar programin e AKM-së për ngritjen e kualifikimeve të mësimitdhënësve prej shkollave të larta pedagogjike dyvjeçare në nivelin bachelor.

Sukseset dhe sfidat:

Në vazhdimësinë e punë së MASHT-it janë shënuar suksese në zhvillimin profesional të mësime dhënësve në partneritet me donatorët tjerë. Për realizimin dhe vazhdimësinë e këtyre proceseve kemi shumë sfida, të cilat kërkojnë angazhim dhe përkushtim të veçantë deri në arritjen e realizimit të objektivave të caktuara.


Të arriturat :

- Është siguruar programi softwerik për vendosjen e data bazës së të dhënave dhe është vendosë sistemi I bazës së të dhënave për licencim, ku bartës është sektori I trajnimeve.
- Në procesin e licencimit të mësimdhënësve kanë aplikuar mbi 19.000 mësimdhënës dhe kanë fituar të drejtën e marrjen së licencave të karrierës.
- Janë trajnuar mbi 10,000 mësimdhënës nga ofertues të ndryshëm në partneritet me MASHT-in në programet :PTHA,/BEP 8 programe, Programi për Udhëheqje arsimore, programi për matematikë niveli 1-5 dhe 6-9,GIZ, USAID,KE-IPA 2009 komponentë 1 dhe 3, Kulturë kontakt Austria, Firmat ushtrimore dhe Metodatat e reja te mësimdhënies, KNKK programi HDH-së ,Save the children,UNICEF,KEC, etj.

Sfidat:

- ***Në kohën kur aftësimi i mësimitdhënësve pa shkëputje nga puna është bërë i obliguar për të gjithë mësimitdhënësit, sfida më e madhe mbetet:***
- **Ndërtimi i kapaciteteve trajnuese dhe ofrimi i trajnimit për të gjithë mësimitdhënësit.**
- **Procesi i zhvillimit të kurrikulave të reja, i cili ka filluar zbatimin , do të ketë rol kyq pasi që do të kërkojë përgatitjen e mësimitdhënësve dhe zotërimin e metodave të reja të të nxënies dhe të mësimitdhënies për zbatimin e kurrikulave të reja.**
- **Të sigurohet një buxhet afatgjatë dhe i parashikueshëm për aftësimin e mësimitdhënësve si dhe të krijohen mekanizmat për menaxhimin financiar për ZHPM prej niveleve qendrore në ato komunale**

- MASHT duhet të sigurojë një sistem të stimulimeve të rregullta në paga për vlerësimin dhe promovimin e mësimitdhënësve si pjesë e procesit të licencimit.
- Zhvillimi i sistemit për menaxhimin e të dhënave për Licencimin e mësimitdhënësve (analiza dhe vlerësimi informatave për aftësimin e mësimitdhënësve) në nivel të MASHT-it dhe monitorimit të zbatimit të programeve trajnuese.
- Sigurimi i aftësimin pedagogjik për mësimitdhënësit e AAP pa përgatitje pedagogjik gjatë studimeve të rregullta. Mësimitdhënësit që nuk kanë pasur përgatitje pedagogjike gjatë studimeve të tyre të rregullta do të duhet të përfitojnë nga programe të aftësimin pedagogjik pa shkëputje nga puna. Në kontekstin e tanishëm, do të zhvillohet një kurs i bazuar në nevojat përkatëse në suaza të kornizës për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe të procesit për licencimin e mësimitdhënësve.

- 
- *Nevoja për gradim të mësimdhënësve për të ardhmen, është e domosdoshme për rritjen e potencialeve të nxënësve, zhvillimin e shkathtësive të tyre kreative dhe analitike për zgjidhjen e problemeve dhe ndërtimin e mendimeve dhe ideve në situata reale të jetës.*
 - *Zbatimi i KKK në Kosovë do ta sjellë mësimdhënësin në një situatë të reformimit më të shpejt në arritjen e standardeve dhe kompetencave në aspektin profesional. Roli i mësimdhënësit nuk është më që të bartë informacione, por të ofrojë një mjedis të përshtatshëm ku mund të mësojnë të gjithë nxënësit detyrat dhe aktivitetet mësimore.*



Faleminderit për vemendje!